



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr. 5297/prot.
1

Himarë, më 17.11.2023

PROJEKTVENDIM

NR 45, DATË 17.11.2023

**PER DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ME
NR.54, DATË 25.11.2021
“PËR PAKETËN FISKALE TË VITIT 2022 PËR BASHKINË HIMARË”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”; të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore, vendim nr. 132, datë 07.03.2018 për metodologjinë për përçaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e ndryshuar, të VKM-së nr. 319, datë 31.05.2018, “ Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, Këshilli i Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 54, datë 25.11.2021 “Për paketën fiskale të vitit 2022 të Bashkisë Himarë”, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në 1 janar 2024.

DREJTOR
Donald Bello

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Ndryshimet në paketën fiskale për vitin 2024:

Në faqen 14 të Paketës Fiskale mbi taksën e fjetjes në hotel zëvendësohet togfjalëshi

- sezoni llogaritet për 60 ditë
- me
- sezoni llogaritet për 75 ditë, vetëm në rastet kur nuk bëhet e mundur rakordimi mujor i regjistrave të klientëve të subjektit të regjistruar pranë drejtorisë së të ardhurave.

në faqen 18 të Paketës Fiskale mbi tarifën e pastrimit në tabelën përmbljedhëse zëvendësohet tabela nga :

- Në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit Bashkia Himarë do të përdorë politika zbutëse për tarifimin e familjarëve si më poshtë:

	2023	2024	2025
Politika zbutëse e tarifimit	50%	60%	70%

me

- Në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit Bashkia Himarë do të përdorë politika zbutëse për tarifimin e pastrimit si më poshtë:

	Norma e rritjes së tarifës së pastrimit për familjarët	Norma e rritjes së tarifës së pastrimit për Bizneset
Viti ushtrimor 2024	10%	15%
Viti ushtrimor 2025	10%	15%
Viti ushtrimor 2026	10%	15%

Në seksionin:

LE TARIFA PËR KULLOTAT ME DESTINAÇION BLEGTORINË, BIMË MEDICINALE

në faqen 18 shtohen tarifat për vaditje si më poshtë:

Tarifë vaditje	sezon/ përdorues	4000 all
Tarifë Vaditje (Sipërfaqe të mëdha)	km2	1500 all

Shtohet seksioni : TAKSA TË PËRKOHSHME

Emërtimi: tarifë e përkohshme për projektimin dhe rikonstruksionin e rrugëve dytësore subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Himarë me veprimtari turizmin:

Hoteleri	< 8 dhoma	4000 all
	> 8 dhoma	10000 all
Restorant		6000 all
Bar Kafe		4000 all

Janë të përjashtuar nga taksa e përkohshme

Në seksionin DISA RREGULLA PER TAKSA - TARIFAT

Shtohet rregulli 15 si më poshtë:

- të gjitha subjektet ose familjarët të çilët do të pajisen me panele diellore për ngrohjen e ujit apo për prodhimin e energjisë për nevojshmëritë e subjektit do të inçentivohen mbi tarifën e ndriçimit deri në masën 30% për subjektet dhe përjashtim për familjarët për 3 vitet pasardhës nga kryerja e investimit.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe të gjithë Njësitë Administrative dhe Drejtoritë e Bashkisë Himarë si dhe ndërmarjet apo institucionet e tjera në varësi të saj.

Drejtori i DA
Donald Bello



Drejtori i DFPBIE
Laert Mezani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Mr. 5297/2 prot.

17.11.2023

Lënda: Relacion shpjegues mbi projekt vendimin për disa ndryshime mbi paketën fiskale për vitin 2024.

Të nderuar këshilltarë,

Ju paraqesim bashkëlidhur propozimet për paketën fiskale për vitin 2024. Ndryshimet e paraqitura në DraftVendim reflektojnë ndryshimet ligjore, propozimet e ardhura nga komuniteti dhe propozimet tuaja të diskutuara me anëtar të komisionit të ekonomisë.

Taksa e fjetjes në hotel

Këndvështrimi Juridik: Nënvizojmë që ndryshimet janë në përputhje me bazën ligjore të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore i ndryshuar,

Neni 26 Taksa e fjetjes në hotel

1. Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë.
3. Niveli i taksës është deri në 5 për qind të çmimit të fjetjes.
4. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë kategori dhe nënkategori për klasifikimin e hoteleve, si dhe të vendosë për nivelin përkatës të taksës, brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.
5. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia ose komuna me çmimin e fjetjes dhe numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
6. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i çili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë ose të komunës, në territorin e së çilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
7. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo komunës, në juridiksionin e së çilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Gjendja Aktuale

Aktualisht në territorin e Bashkisë Himarë niveli i taksës siç përçaktohet në tabelën përmbledhëse:

Zona	ZONA A Njesia Administ.Himare	ZONA B Njesia Administ.Lukove	ZONA Ç Njesia Administ.Hore- Vranisht
Emërtimi	HIMARË	LUKOVË	VRANISHT
Hotele	130 lekë për 1 natë	100 lekë për 1 natë	100 lekë për 1 natë
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përçaktimeve të ligjit për turizmin	40 lekë për 1 natë	40 lekë për 1 natë	30 lekë për 1 natë

Është i kategorizuar në tre kategori në varësi të zonave ku ushtrohet aktiviteti i strukturave akomoduese përkatësisht në Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Krahas kategorizimit për diferencimin e subjekteve që ushtrojnë këtë aktivitet ekonomik në paketën fiskale përaktohet dhe një klasifikim të subjekteve, duke ndarë Hotelet nga dhomat me qira, bujtinat apo çfarëdolloj strukture tjetër akomoduese.

Në rastin e mosdorëzimit të regjistrat të klienteve sektori përgjegjës kryen përllogaritjen me formulën si më poshtë:

$$V_t = T_f * N_r \Delta * D$$

Ku:

V_t = Vlera e taksës për tu paguara

T_f = Taksa e fjetjes sipas kategorizimit dhe klasifikimit përkatës

$N_r \Delta$ = Numri i dhomave të subjektit

D = Ditët e qëndrimit **60 ditë**

Ndryshimet e Propozuara: Bazuar në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore, ndryshimet e propozuara janë në lidhje me taksën e fjetjes në hotele dhe strukturat akomoduese të ngjashme në territorin e Bashkisë Himarë.

Në propozimin e përcjellë këshillit nga **60 ditët** e qëndrimit shkon në **75 ditë**.

Argumentimi i Ndryshimeve: Ndryshimet janë të nevojshme për të përmirësuar zbatimin e taksës së fjetjes në mënyrë që të përputhet më mirë me karakteristikat e zonave të ndryshme të Bashkisë Himarë. Viti 2023 ishte një vit i suksesshëm në sektorin e turizmit dhe rritja e numrit të ditëve për përllogaritjen e taksës së fjetjes përkon me rritjen ekonomike në këtë sektor i çili pavarësisht rritjes nuk po i kërkohet këshillit të rrisë taksën e fjetjes por të harmonizojë arkëtimin e kësaj takse me zhvillimet sektoriale, më ngushtësisht të nxisë subjektet (sidomos bujtinat, dhomat me qira) që të përdorin regjistrat e klientëve. Për arkëtimin e kësaj takse.

Tarifa e pastrimit

Këndvështrimi Juridik: Propozimet janë në përputhje me Vendim nr. 319, datë 31.5.2018 për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Principet e vendosjes së tarifës

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të përcaktuar tarifën që gjeneruesit duhet të paguajnë për shërbimet e mbetjeve (për shembull bazuar në konsumin e energjisë elektrike, në numrin e dhomave në shtëpi, në vëllimin e ndërtesës, në vlerën e ndërtesës, në numrin e njerëzve që jetojnë në shtëpi, në numrin e koshave dhe shpeshësinë e grumbullimit etj.). Asnjë prej tyre nuk është i përsosur dhe të gjitha sistemet janë subjekt i diskutimeve. Zhvillimi i modeleve dhe, në terma të përgjithshëm, vendosja e tarifave bazohet në parimet kryesore të rikuperimit të kostos:

- **Mbulimi i kostos:** menaxhimi i mbetjeve duhet të sigurojë mbulimin e plotë të kostos, e çila përfshin koston e operimit dhe mirëmbajtjes, kostot administrative dhe të amortizimit.

- **Ndotësi paguan:** gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë për eliminimin e saj në mënyrë sa më proporcionale, në zbatim të praktikave të mira, duke nxitur reduktimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riçiklimin, si dhe duke iu shmangur sa më shumë të jetë e mundur hedhjes së mbetjeve në natyrë.

- **Barazia:** gjenerues të ngjashëm të mbetjeve duhet të paguajnë mundësisht tarifa të ngjashme. -

Ekvivalenca: shuma e tarifave të mbledhura duhet të jetë në përputhje me atë të shpenzimeve (jo nën e as mbi); të ardhurat nuk mund të përdoren për qëllime të tjera (p.sh. rrugë apo ujësjellës). -

Transparenca: tarifat duhet të reflektojnë kostot dhe qytetarët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente për kostot dhe llogaritjen e tarifave.

- **Thjeshtësia:** një element shumë i rëndësishëm është përcaktimi i një sistemi të thjeshtë, përshtatur në të dhëna të përballueshme dhe sa më i lirë të jetë i mundur në koston e aplikimit (llogaritja e faturimit dhe arkëtimit).

Gjendja aktuale

Tarifa e pastrimit është detyrim i orientuar drejt kostos së shërbimit. Tarifës i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Himarë dhe njësisve të saj administrative. Mbështetur në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", bashkia përdori modelin progresiv për llogaritjen e nivelit të tarifave për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të shoqëruar me disa politika zbutëse, sidomos në vitin e parë të aplikimit.

Për mbulimin e kostos së Shërbimit të pastrimit alokimi i kostove është i shpërndarë si më poshtë:

	Për familjet		38%
	Për Institucionet		2%
Politika e Ndarjes së Kostos/sipas gjenerimit të mbetjeve, PMMN	Për Bizneset		60%

Formula e Përllogaritjes së Tarifës së Pastrimit për Familjarët

$$TP = TM * (1 + \sum PnF) * Dp * Pz$$

TP - Tarifa e Pastrimit

TM - Tarifa mesatare që është e barabartë me Totalin e Kostos së Alokuar për Familjarët pjesim për numrin e tyre.

PnF - Përqindja e Ndryshimit të Faturimit. Si shpjegohet në tabelën e mëposhtme është shuma e të gjithë variablave me peshën e tyre specifike në rritjen ose uljen e tarifës së përllogaritur.

Dp - Diskriminanti pozitiv

Pz - Politika zbutëse e Tarifimit

Në funksion të përlogaritjes së tarifës së pastrimit për familjarët përdorën variablat e mëposhtëm të cilët mbledhen me faktorin e faturimit:

	Faktorët e Faturimit	Pesha e Ponderuar %	Pesha Specifike e Faktorit	Pesha Specifike ne %	Përqindja e ndryshimit te Faturimit
1	2	3	4	5	6
Diskriminant Negativ	Sipërfaqje e Ndërtesës ne Perdorim	Sipërfaqje e Ndërtesës ne Përdorim/ Sipërfaqje Totale të Ndërtesave	1000	37,50%	3*4
	Sipërfaqje e truallit	Sipërfaqje e truallit/ Sipërfaqje totale e Truallit	500	25,00%	
	Sipërfaqje e Tokës Bujqësore	Sipërfaqje e Tokës Bujqësore/ Sipërfaqje Totale e Tokës Bujqësore	200	12,50%	
	Numri i Familjarëve në Familje	Numri i Familjarëve në Familje/ Numri total i Familjarëve	300	25,00%	
	Distança Nga Pika e Mbledhjes	Distança Nga Pika e Mbledhjes/ Distançat totale nga Pika e mbledhjes	0	0,00%	
				Koefiçienti i përlogaritjes së TP	
Diskriminant Pozitiv	Pensionistë/Invalidë			70%	
	Ndihmë Ekonomike			0%	
	Riçiklim Në Burim			80%	
	Zonë me Politika Zbutëse NJA H. Vranisht Çorraj, Fterrë, Pilur, Kudhës			50%	
	Sipërfaqje e Ndërtesës në Dispozicion			70%	

Në përlogaritjen e tarifës së pastrimit Bashkia Himarë do të përdorë politika zbutëse për tarifimin e familjarëve si më poshtë:

	2023	2024	2025
Politika zbutëse e tarifimit	50%	60%	70%

Në rast të mungesës së informacionit nga sektori i të ardhurave për aplikimin e metodologjisë së tarifës së pastrimit sipas variablave të sipërpërkthuar do të aplikohet tarifimi si më poshtë:

RET (për Familje)	
NJA= Himarë	1600
NJA = Lukovë,	1600
NJA = Horë-Vranisht,	800
erraj,Pilur, Kuthës	

Pas përfundimit të mbledhjes së informacionit Sektori i të Ardhurave do të kryejë rakordimet dhe do të faturojë individin për diferençat në vitin pasardhës.

Në rast të ndryshimit të numrit përfundimtar të klientëve ndryshimet në metodologjinë e përlogaritjes do të pasqyrohen vitin pasardhës.

Çdo kryefamiljar i çdo kategorie që minimizon mbetjet, pra që komposton apo mbledh dhe dorëzon tek kompanitë riçikluese apo sipërmarrësi i pastrimit mbetjet e riçiklueshme, përfiton ulje të nivelit të tarifës në masën 20% të tarifës së llogaritur.

- Çdo klient vërteton nëpërmjet fotografikimit apo raportimit tek Drejtoria e Shërbimeve Publike/supervizori procesin e minimizimit të mbetjeve.
- Drejtoria e Shërbimeve Publike çdo muaj shtator, përpara miratimit të paketës fiskale, dorëzon tek Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Social, të konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë, listën e familjeve, bizneseve apo institucioneve që minimizojnë mbetjet.

Drejtoria e të ardhurave deklaron listën e reduktimit të tarifës për çdo subjekt për miratim në këshillin e bashkisë llogarit impaktin në buxhetin e vitit më pas.

Niveli i tarifës sipas kategorieve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet sipërmarrës në territorin e Bashkisë Himarë dhe janë si më poshtë:

Nr	Kategoritë	Xhiro	BM
		2-8 milion	
		Leke/vit	Leke/vit
I	BIZNESI		
LI	SHITJE ME PAKICË		
	Mish, peshk	14,000	60,000
	Bulmet,Fruta, perime, ushqimore	22,000	50,000
	Artikujt industrialë (veshje, parfumeri, argjendari, etj të ngjashme me to).	8000	30,000
	Bar kafe	30000	50,000
	Restaurant, fast food etj të ngjashme me to	40000	60,000
	Pub, diskoteka etj të ngjashme	38000	50,000
	Vendosje tavolina në muaj në hapësirat publike për tavolinë. Për subjektet (bar, kafe, restorant, fast food, kafe	1,500	

	Internet etj të ngjashme me to).		
	Dendra interneti	8,000	20,000
	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, hidrokarbure etj të ngjashme me to.	40,000	70,000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to (depo farmaceutike të regjistruara si biznes i vogël) etj të ngjashme me to	10,000	20,000
		10,000	20,000
I.2	SHITJE ME SHUMICË		
	Magazina, dyqane, etj të cilat realizojnë shitje me shumicë	40000	80,000
I.3	NJËSI PRODHIMI		
	Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapiçerie letre, kartoni, plasmasi etj të ngjashme me to	40,000	80,000
	Prodhim tulla, tjegulla, bloqe betoni, furra gëlqereje, nyje inerte etj, të ngjashme me to	60,000	90,000
	Prodhime ushqimore, bukë, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj të ngjashme me to.	40,000	70,000
	Prodhim konfeksione, etj të ngjashme me to.	8,000	40,000
	Prodhim, përpunim vajrash, naftë , gazi e nënprodukte etj të ngjashme me to.	40000	100,000
	mpiante, territore për therrjen e kafshëve etj të ngjashme me to.	26,000	60,000
	Shtypshkronja etj të ngjashme me to.	32000	40,000
	mpiante, linja për prodhim dhe përpunim e produkteve ushqimore ose të tjera.	26,000	60,000
	Prodhim perpunim produkte farmaceutike etj të ngjashme me to.	26,000	80,000
I.4	SUBJEKTE NDËRTIMI		
	Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, objekte banimi, shërbimi, të përbëra etj të ngjashme me to ,leje ndërtimi	80,000	100,000
	Rikonstruksione të pjesshme	32,000	80,000
	Subjekte Ndërtuese për selinë administrative	20,000	40,000
	Subjektet e Karrierave për prodhim guri, inerte etj të ngjashme me to.	40,000	80,000
I.5	NJËSI SHËRBIMI		
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake, radio televizore, frigorifere, lavatriçe, magnetofon, paisje fonie e të tjera të ngjashme me to.	10,000	50,000
	Shërbime fotokopjimit, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina (autoshkolla) për traktore, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore, agjensi këmbimi valute, agjensi turizmi,, konviktet pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkimi i makinave, agjençi transporti, avanteritë, pastrimi kimik, shërbime të rojeve çivile, sallat	10,000	40,000

Lojra të ndryshme (gjimnastikë, aerobice, çirçe, kënde lojrash për fëmijë, ping pong, etj.) e të tjera shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura.		
Shtëpi botuese, biblioteka	10,000	50,000
Hotele, motele (lekë/dhomë në vit)	1,500	2,000
Njësi shërbimi marangoz, robaqepës, këpuçar, floktore, brëndreqës etj	10,000	30,000
Komplekse sportive, palestra, fitnes, pishina, qendra e institute kërkimore-shkençore, salla koncerte-mbledhje e videoteka	10,000	50,000
Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura, Lojra fati	10,000	60,000
Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo erdhet), shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë	10,000	50,000

Diagnostifikimi		
Institucione Shtetërore SH.A, Institucione financiare, postare, portuale për çdo Vendndodhje	800,000	
Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe në kategoritë si më lart)	10,000	30,000
L.6 SHOQATA, FONDAÇIONE, ENTE TE NDRYSHME SHTETERORE, ORGANIZATA OQEVERITARE	10,000	
L.7 PROFESIONE TË LIRA		
Avokatët, noter, mjek, mjeku-laborant, stomatologu, farmacisti, ekonomisti kontabël të miratuar, eksperti kontabël të autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e të tjera profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	12,000	30,000
Galeritë e artit të piktoreve, skulptoreve dhe artisteve të tjerë që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	12,000	30,000
Institucionet jopublike të edukimit (shkollat, kopshtet apo erdhet), shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorë diagnostifikimi etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e regjistrimit në TVSH.	12,000	50,000
L.8 AMBULANT		
Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	8,000 ₁	
L.9 TRANSPORT		
Transport pasagjerësh		

Automjetet deri 5 vende	3,000	20,000
Automjetet 6-9 vende	4,000	20,000
Automjetet 10-25 vende	5,000	20,000
Automjetet 26-42 vende	6,000	20,000
Automjetet mbi 42 vende	7,000	20,000
Transport Mallrash		
Automjetet deri 2 tonë	3,000	20,000
Automjetet 2-5 tonë	4,000	20,000
Automjetet 5-10 tonë	5,000	20,000
Automjetet 10-16 tonë	6,000	20,000
Automjetet mbi 16 tonë	7,000	20,000

TRANSPORT UJOR		
Transport detar jashte vendit	8000	10000
Transport udhëtare brenda vendit	5000	6000
Transport udhëtare brenda vendit	5000	6000
Anije kënaqësie	5000	8000

Mënyra e pagesës

Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor.

"Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit".

Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje në vit, për të gjitha rastet që nuk mund të përfshihen në pikën e mësipërme. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë agjentit tatimor përkatës certifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes çivile.

Për kategorinë II. "Biznesi" detyrimi paguhet brenda vitit tatimor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitetet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.

Për kategorinë II. "Subjekte Ndërtimi" nënkategorinë "Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to" "Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to", llogaritja e tarifës së pastrimit të fillojë me zbardhjen e lejes së ndërtimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Himarës. Këtu përjashtohen kantierët e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Ndryshimet e Propozuara:

- Në përlogaritjen e tarifës së pastrimit Bashkia Himarë do të përdorë politika për tarifimin e pastrimit si më poshtë:

	Norma e rritjes së tarifës së pastrimit për familjarët	Norma e rritjes së tarifës së pastrimit për Bizneset
Viti ushtrimor 2024	10%	15%
Viti ushtrimor 2025	10%	15%
Viti ushtrimor 2026	10%	15%

Detajet e Ndryshimeve: Ndryshimet propozojnë një normë të rritjes së tarifës së pastrimit për familjarët dhe bizneset, respektivisht në vitin ushtrimor 2024, një rritje prej 10% do të aplikohet për familjarët dhe 15% për bizneset. Një rritje e ngjashme është propozuar edhe për vitet e mëvonshme.

Argumentimi i Ndryshimeve

Ndryshimet janë të nevojshme për të siguruar që tarifa e pastrimit reflekton koston e operimit, mirëmbajtjes, kostot administrative, dhe të amortizimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu, ndryshimet janë në përputhje me parimet kryesore të rikuperimit të koston, duke përfshirë mbulimin e koston së plotë, inkurajimin e reduktimit të mbetjeve, ripërdorimit dhe riçiklimit, si dhe barazinë dhe ekuivalencën në tarifa.

Tarifa e vaditjes

Këndvështrimi Juridik Ky dokument zbatohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore të Shqipërisë që rregullojnë vaditjen dhe tarifat vendore Ligj Nr. 24/2017 për administrimin e ujitjes dhe të kullimit.

Neni 18 Tarifa e Shërbimit të Ujitjes

1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri.

2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.

3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përlogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Neni 19 Miratimi i tarifave Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe tarifa e shërbimit të ujitjes miratohen nga këshilli bashkiak.

Gjendja Aktuale Në territorin e Bashkisë Himarë shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore së ujitje kullimit përballohen nga të gjithë taksapaguesit pavarësisht aktivitetit të tyre ekonomik, duke mos tarifuar individët ose subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik në sektorin bujqësor.

Ndryshimet e Propozuara:

Në seksionin:

LE TARIFA PËR KULLOTAT ME DESTINAÇION BLEGTORINË, BIMË MEDICINALE

në faqen 18 shtohen tarifat për vaditje si më poshtë:

Tarifë vaditje	sezon/ përdorues	4000 all
Tarifë Vaditje (Sipërfaqe të mëdha)	km2	1500 all

Argumentimi i ndryshimeve

Ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë situatën në sektorin e vaditjes. Vendosija e tarifës për vaditjen sezonal/përdorues dhe sipërfaqet e mëdha do të sigurojë burime financiare të nevojshme për të përmirësuar infrastrukturën e ujitje kullimit. Kjo do të adresojë sfidat aktuale të kujdesit për kanalet vaditëse dhe do të përmirësojë përvojën e vaditjes për komunitetin.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndryshimet e propozuara do të çojnë në rritjen e investimeve institucionale në sektorin e vaditjes. Më shumë të ardhura do të shpenzohen për mirëmbajtjen e kanaleve vaditëse dhe kanaleve kulluese. Rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve publike në lidhje me vaditjen, dhe tërheqjen e kapaciteteve profesionale për menaxhimin dhe zhvillimin e sektorit ekonomik.

Në përfundim, ndryshimet e propozuara në tarifën e vaditjes janë të dëshmuara për të adresuar sfidat aktuale dhe për të sjellë investime të rëndësishme institucionale në sektorin e vaditjes. Këto ndryshime do të sigurojnë një shërbim më të mirë për komunitetin tonë dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe mjedisit të qytetit. Është koha që të marrim masa dhe të investojmë në të ardhmen e bashkisë sonë.

Taksa të përkohshme

Këndvështrimi Juridik: ndryshimet janë në përputhje me bazën ligjore të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, nen 33 taksa te përkohshme, Këshilli bashkiak ose komunal, kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij.

Gjendja aktuale:

Përdorimi i infrastrukturës në Bashkinë Himarë, destinacioni i preferuar turistik në Shqipëri, është një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të kësaj zone. Infrastruktura, e çila përfshin rrugët, kanalizimet, ujin, energjinë elektrike, telekomunikacionet, dhe të tjera shërbime dhe objekte publike.

1. Përdoruesit e Infrastrukturës:

- Turistët: Turistët janë një prej përdoruesve më të rëndësishëm të infrastrukturës së kësaj zone. Ata përdorin rrugët, plazhet, restorantet, hotelet, dhe shërbimet turistike.

- Bizneset turistike: Bizneset si hotelet, restaurantet, baret, agjençitë turistike, dhe dyqanet lokale janë përdorues të tjerë të infrastrukturës. Ata përdorin energjinë elektrike, ujin, dhe shërbimet e tjera për të ofruar shërbimet e tyre.

- Banorët vendas: Banorët e Himarës janë përdorues të përhershëm të infrastrukturës. Ata përdorin rrugët, shërbimet e furnizimit me ujë dhe energji elektrike për nevojat e tyre të përditshme.

- Transporti i mallrave dhe ushqimit: Infrastruktura e transportit është e rëndësishme për furnizimin me mallra dhe ushqime të zonës. Kjo përfshin importin dhe eksportin e mallrave, si dhe furnizimin me ushqime për turistët dhe banorët vendas.

2. Kostot e Amortizimit:

- Kostot e amortizimit janë shuma e parave që duhet të shpenzohen për mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës. Në zonën turistike të Bashkisë Himarë, amortizimi është i rëndësishëm për të mbajtur në gjendje të mirë rrugët, ujin, energjinë elektrike dhe të tjera pasuri publike. Përdorimi intensiv i infrastrukturës nga turistët gjatë sezonit veror mund të rrisë kostot e amortizimit.

3. Faktorë të Tjerë:

- Sezoni turistik: Bashkia Himarë përballen me një lëvizje intensive të turistëve gjatë sezonit veror. Kjo ndikon në rritjen e përdorimit të infrastrukturës dhe kostot e kujdesit të saj. Mund të ketë nevojë për investime shtesë për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të përballuar volumin e madh të turistëve gjatë verës.

- Mbrojtja e mjedisit: Përdorimi i infrastrukturës duhet të kujdeset për ruajtjen e mjedisit. Zona turistike e Bashkisë Himarë përfshin plazhet dhe natyrën e bukur, kështu që është e rëndësishme të kujdeset për mbrojtjen e tyre.

- Zhvillimi i qëndrueshëm: Planifikimi i zhvillimit të infrastrukturës duhet të përfshijë parashikimin për rritjen e turizmit dhe nevojat e të ardhmes, duke përmirësuar infrastrukturën në mënyrë që të jetë e qëndrueshme dhe e përputhur me karakteristikat e vendit.

Përdorimi i infrastrukturës në Bashkinë Himarë është një çështje komplekse që duhet të menaxhohet me kujdes për të përballuar nevojat e turistëve, bizneseve dhe banorëve vendas, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

Aktualisht të gjitha investimet e kryera përballohen nga taksatpaguesit pavarësisht përdorimit të infrastrukturës në territor. Për këtë qëllim anëtarë të komisionit të ekonomisë por dhe grupe të interesit kanë propozuar ndryshime në menaxhimin e këtij sektori kaq të rëndësishëm për rritjen ekonomike të territorit

Ndryshimet e Propozuara:

Shtohet seksioni : **TAKSA TË PËRKOHSHME**

Emërtimi: tarifë e përkohshme për projektimin dhe rikonstruksionin e rrugëve dytësore subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Himarë me veprimtari turizmin:

Hoteleri	< 8 dhoma	4000 all
	> 8 dhoma	10000 all
Restorant		6000 all
Bar Kafe		4000 all

Argumentimi i ndryshimeve:

Këto ndryshime do të inkurajojnë subjektet që ushtrojnë aktivitetin e turizmit të kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, e çila është në avantazh të të gjithë banorëve dhe vizitorëve të Bashkisë Himarë. Tarifat e reja janë të ndikimit të shkurtër të një periudhe turistike dhe do të ndihmojnë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, duke përmirësuar kështu përvojën e të gjithë atyre që vizitojnë këtë zonë të bukur turistike. Fondi i krijuar do të shërbejë për projektimin, mirëmbajtjen dhe k

Incentiva Fiskal

Në seksionin **DISA RREGULLA PER TAKSA - TARIFAT**

Shtohet rregulli 15 si më poshtë:

- të gjitha subjektet ose familjarët të çilët do të pajisen me panele djellore për ngrohjen e ujit apo për prodhimin e energjisë për nevojshmëritë e subjektit do të inçentivohen mbi tarifën e ndriçimit deri në masën 30% për subjektet dhe përjashtim për familjarët për 3 vitet pasardhës nga kryerja e investimit.

Për shkak të kostos së lartë të energjisë elektrike në vendimin nr.584, datë 8.10.2021, të këshillit të ministrave, "për shpalljen e gjendjes së emergjençës në furnizimin me energji elektrike", të ndryshuar kemi parashikuar disa inçentiva të çilët së bashku me inçentivat e qeverisjes qendrore do ta bëjnë më të lehtë kalimin e krizës energjitike në të ardhmen. Si parashikohet në projekt propozimin e paketës fiskale të gjitha subjektet të çilat do të pajisen me panele djellore për ngrohjen e ujit apo për prodhimin e energjisë për nevojshmëritë e subjektit ose familjarëve do të inçentivohen mbi tarifën e ndriçimit deri në masën 30%.

Drejtori i DA
Donald Bello



Drejtori i DFPBIE
Laert Mezani



KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

